


# Aksidentet Rrugore

## Dhjetor 2017

**Tiranë, më 22 Janar 2018:** Në muajin Dhjetor 2017 numërohen 132 aksidente rrugore, krahasuar me Dhjetor 2016, numri i aksidenteve është ulur me 28,6 %.

Në vitin 2017, numri i aksidenteve është 1.978, krahasuar me vitin 2016 është ulur 2,7 %

**Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Dhjetor 2013 - Dhjetor 2017**



Numri i të aksidentuarve në Dhjetor 2017 është 170 persona, krahasuar me njëjtin muaj të 2016 është ulur 25,1 %.

Në vitin 2017, numri i të aksidentuarve është 1.978 persona, duke u ulur me 6,0 %, krahasuar me vitin 2016.

Numri i personave të plagosur gjatë muajit Dhjetor 2017 është 154. Krahasuar me mesataren e personave të plagosur gjatë vitit 2016, ky numër është ulur me 26,4 %.

Në vitin 2017, numri i personave të plagosur nga aksidentet rrugore është 2.389. Krahasuar me numrin e personave të plagosur të vitit 2016 është ulur 4,8 %.

Në Dhjetor, aksidentet rrugore, në 81,8 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit.

Në vitin 2017, aksidentet rrugore, të cilat kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit, zënë 81,3 % të rasteve. Numri më i lartë i aksidenteve është kryer nga grup moshë 25 – 35 vjeç, duke zënë 27,9 % të numrit të aksidenteve rrugore.

**Tab. 1 Aksidentet rrugore, Dhjetor 2017**

Periudha	Aksidente	Të vdekur		Të plagosur	
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Dhjetor - 2016	185	5	21	60	141
Dhjetor - 2017	132	5	11	44	110
Ndryshimi vjetor (%)	-28,6	0,0	-47,6	-26,7	-22,0
Janar - Dhjetor 2016	2.032	51	218	772	1.737
Janar - Dhjetor 2017	1.978	42	180	723	1.666
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-2,7	-17,6	-17,4	-6,3	-4,1

**Tab. 2 Aksidentet rrugore sipas përdoruesve të rrugës, Dhjetor 2017**

Periudha	Aksidente sipas		Të vdekur sipas	
	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve
Dhjetor - 2016	152	33	17	9
Dhjetor - 2017	108	24	9	7
Janar - Dhjetor 2016	1.728	304	213	56
Janar - Dhjetor 2017	1.608	370	173	49

**Tab. 3 Aksidentet rrugore sipas moshës së drejtuesit të mjetit, Dhjetor 2017**

Periudha	0 - 16 vjeç	16 - 25 vjeç	25 - 35 vjeç	35 - 45 vjeç	45 - 60 vjeç	60+ vjeç	Larguar nga vendi i ngjarjes
Dhjetor - 2016	0	28	58	25	41	9	24
Dhjetor - 2017	1	23	37	18	36	9	8
Janar - Dhjetor 2016	13	388	595	328	413	151	144
Janar - Dhjetor 2017	6	420	552	316	403	162	119

**Tab. 4 Aksidentet rrugore sipas qarqeve, Dhjetor 2017**

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Aksidente		Të vdekur	
	Dhjetor-2016	Dhjetor-2017	Dhjetor-2016	Dhjetor-2017	Janar-Dhjetor 2016	Janar-Dhjetor 2017	Janar-Dhjetor 2016	Janar-Dhjetor 2017
Shqipëria	185	132	26	16	2.032	1.978	269	222
Tiranë	81	52	5	4	767	783	65	54
Durrës	10	15	4	2	237	256	37	28
Shkodër	16	4	4	2	133	48	27	23
Elbasan	13	18	1	3	158	166	17	19
Fier	12	8	5	2	145	118	26	29
Vlorë	11	5	0	0	100	137	12	10
Korçë	16	4	1	0	145	101	21	12
Lezhë	11	19	2	3	188	213	27	27
Berat	7	1	2	0	52	42	7	1
Kukës	4	3	2	0	45	42	8	7
Dibër	3	1	0	0	32	36	9	1
Gjirokastrë	1	2	0	0	30	36	13	11

# Përkufizime

**Aksidente:** Aksidentet rrugore që ndodhin tek një ose më shumë persona që goditen nga mjetet e qarkullimit rrugor.

**I vdekur:** I vdekur nga aksidenti në rrugë quhet çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit.

**I plagosur:** I plagosur konsiderohet çdo person, i cili nuk ka vdekur por ka marrë plagë të lehta apo të rënda si rezultat i aksidentit.

**Sjellja e Drejtuesit të Mjetit :** Nënkupton nëse drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: frenim i papritur, injoron shenjat (sinjalistikën) e trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë etj.

**Sjellja e Këmbësorëve:** Nënkupton nëse këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si : kalim rruge pa kujdes, etj.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

*Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.*